

VENDIM
Nr.13, datë 15.3.2010

**PËR RINOVIM LICENCE PËR EFEKT TË NDRYSHIMIT TË DREJTUESIT LIGJOR
DHE TEKNIK SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit sh.a ujësjellës- kanalizime Tiranë me:
Drejtues ligjor z. Sahit Shefqet Dollapi
Drejtues teknik z. Luan Isuf Peti
2. Operatori sh.a Tiranë autorizohet ta kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia: Tiranë, Kamëz, Vorë

 Komuna: Prezë Farkë
 Petrelë Krrabë
 Dajt Bërxull
 Baldushk Vaqar
 Zall – Herr Pezë
 Kashar Ndroq
 Paskuqan

Kjo licencë është e vlefshme deri me datë 29.12.2012 siç është përcaktuar në vendimin nr. 38/5 të KKRR në datë 29.12.2008.

KRYETARI I ERRU
Avni Dervishi